



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 63

Prishtinë, më 20 shtator 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Skënder Hyseni, Sabri Hamiti, Emilija Rexhepi, Hamza Balje.

Munguan: Berat Buzhala, Donika Kadaj-Bujupi.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe praktikantja Gurjeta Zeka.

Nga Zyra për Protokoll e Marrëdhënie Ndërkombëtare: Tringa Lila e Ariana Musliu.

Mbledhjen e kryesoi, Albin Kurti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 26 korrik 2013;
3. Shqyrtimi i propozimit për formimin e grupeve të miqësisë;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 26 korrik 2013

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi njëzëri procesverbalin nga mbledhja e mbyllur e dt. 16 korrik dhe procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 26 korrik 2013.

3. Shqyrtimi i propozimit për formimin e grupeve të miqësisë

Albin Kurti, lidhur me formimin e grupeve të miqësisë, theksoi se Komisionit i është proceduar propozimi nr. 04/4597/Do-1857, i dt. 6.9.2013, për formimin e grupeve të miqësisë në mes të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe shteteve të Evropës Perëndimore, Australisë dhe Zelandës së Re, shteteve të Lindjes së Mesme, shteteve të Afrikës, shteteve të Azisë së Mesme, përkatësisht shteteve STANI, shteteve të Azisë Jugore, shteteve të Ballkanit, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kanadasë, shteteve të Kaukazit, shteteve të Magrebit, shteteve të Amerikës Latine. Sipas informatave që kemi nga Zyra për Protokoll e Marrëdhënie Ndërkombëtare e Kuvendit, tha se gjatë legjislaturës së kaluar kanë qenë të formuara Grupi i Miqësisë me Britaninë e Madhe, Asamblenë e Francës dhe Kuvendin e Turqisë.

Ai shtoi se sipas rregullës 6, të Rregullores për formimin e grupeve të miqësisë, detyrë e Komisionit është që ta shqyrtojë propozimin dhe t'i rekomandojë Kryesisë së Kuvendit për nismën e formimit të këtyre grupeve të miqësisë.

Anëtarët e Komisionit: S. Hyseni, H. Hyseni, S. Hamiti, E. Rexhepi, E. Kervan e H. Balja, e përkrahën formimin e grupeve të miqësisë mes këtyre shteteve dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës. Lidhur me formimin e këtyre grupeve të miqësisë dhe funksionalizimit të tyre, ata theksuan se është i nevojshëm buxheti, stafi përkatës profesional për mbështetjen e punës së grupeve të miqësisë, të merren parasysh prioritetet për formimin e grupeve të miqësisë, ku si kriter i konkretizimit, do të ishte në njërin anë ai gjeopolitik, gjeostrategjik, partneriteti ekonomik, shkëmbimi tregtar, investimet kapitale, dhe në anën tjetër, kriteri kulturor e historik, si dhe kriteri i grupimit me shtetet që e kanë njohur dhe me ato që nuk e kanë njohur shtetësinë e Republikës së Kosovës.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni e nxori këtë

Përfundim

1. I propozohet Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, që të miratojë propozimin për formimin e grupeve të miqësisë, në mes të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe shteteve të Evropës Perëndimore, Australisë dhe Zelandës së Re, shteteve të Lindjes së Mesme, shteteve të Afrikës, shteteve të Azisë së Mesme, përkatësisht shteteve STANI, shteteve të Azisë Jugore, shteteve të Ballkanit, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kanadasë, shteteve të Kaukazit, shteteve të Magrebit, shteteve të Amerikës Latine.

2. Me rastin e formimit të grupeve të miqësisë, i propozohet Kryesisë së Kuvendit që të ketë parasysh buxhetin e Kuvendit; stafin përkatës profesional për mbështetjen e punës së grupeve të miqësisë; prioritetet në formimin e grupeve të miqësisë, ku si kriter i konkretizimit do të ishin, në njërin anë ai gjeopolitik dhe partneriteti ekonomik (shkëmbimi tregtar e investimet kapitale), dhe në anën tjetër, aspekti kulturor dhe historik, si dhe kriteri i grupimit me shtetet që e kanë njohur dhe me ato që nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës.

4. Të ndryshme.

Me propozim të kryetarit të Komisionit për hartimin nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike të një matrice indikatorësh, për të vlerësuar në baza vjetore performancën dhe përgjegjshmërinë e

Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës, si dhe njësive të saj individuale, me qëllim të rritjes së kontrollit parlamentar mbi këtë segment institucional, Komisioni vendosi që për këtë çështje të diskutojë në mbledhjen e radhës.

Takimi përfundoi në orën 11:40.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.